

VENDIM
Nr. 262, datë 13.3.2012

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 933, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË KËRKESAVE
DHE MASËS SË DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR FAMILJARËT E VIKTIMAVE TË
EKZEKUTUARA PADREJTËSISHT, PA GJYQ, PËR MOTIVE POLITIKE, GJATË PERIUDHËS
30.11.1944 DERI MË 1.10.1991”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë të nenit 2 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I të vendimit nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Pas shkronjës “c” të pikës 6 të shkronjës “A”, “Fillimi i shqyrtimit të kërkesave”, shtohet shkronja c/1, me këtë përmbajtje:

“c/1) aktin administrativ të lëshuar nga komisioni trepalësh dhe/ose dekoratë nderi të dhënë nga Presidenti i Republikës pas datës 1.10.1991, për viktimën e ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike.”.

b) Në pikën 6 të shkronjës “B”, ‘Shqyrtimi i kërkesës’, pas fjalëve “... nuk disponohen të dhëna për kërkuesin ...” shtohen fjalët “..., si dhe kur nuk ka të dhëna të paraqitura nga aplikanti ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha